



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 28, datë 22.04.2022

PËR

AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “PEDAGOGJI E SPECIALIZUAR”, TË UNIVERSITETIT “ISMAIL
QEMALI”, VLORË

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Pedagogji e Specializuar”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “Pedagogji e Specializuar”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Shkresë e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 4237, datë 04.07.2003
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Edukimit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite/6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është “i përmbush pjesërisht standardet”*, me mangësitë si më poshtë:

1. Kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, për këtë program studimi, nuk janë të detajuara.
2. Në planin mësimor të këtij programi studimi, disiplinat të cilat janë derivate të disiplinave të tjera të programit, zhvillohen më herët në kohë se këto të fundit.
3. Literatura e detyrueshme si dhe ajo e rekomanduar, e përfshirë në syllabuset e shumicës së lëndëve të këtij programi studimi, nuk është të paktën, e pesë viteve të fundit.
4. Mungesa e një studimi të mirëfilltë e të përditësuar të tregut të punës, me qëllim identifikimin e nevojave reale të tregut për këtë program studimi.
5. Mungesa e një procesi të miratuar e strukturuar të mentorimit të praktikës profesionale, për studentët e këtij programi studimi.
6. Mungesa e indikatorëve të mirëfilltë dhe të matshëm të impaktit konkret dhe të drejtpërdrejtë që ka pjesëmarrja e personelit akademik të këtij programi studimi, në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në **“Pedagogji e Specializuar”**, të Universitetit **“Ismail Qemali”**, Vlorë, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21/04/2025**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN




Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 28, datë 22.04.2027, "Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në "Pedagogji e Specializuar", të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, janë si vijon:

1. Institucioni, të detajojë kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, për këtë program studimi, si dhe t'ia bëjë të ditura studentëve, që në momentin e regjistrimit të tyre në këtë program studimi.
2. Institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, me qëllim që, një disiplinë, derviate e disiplinave të tjera të programit, të zhvillohet më pas në kohë, si dhe ta pasurojë atë me më shumë terapi për fëmijët me nevoja të veçanta.
3. Institucioni, të marrë masa që, literatura e detyrueshme si dhe ajo e rekomanduar, e përfshirë në syllabuset e të gjitha lëndëve të këtij programi studimi, të jetë të paktën, e pesë viteve të fundit.
4. Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës për të njohur nevojat reale në treg, të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të krijojë një proces të miratuar e strukturuar të planifikimit, ndjekjes e mentorimit të praktikës profesionale, për studentët e këtij programi studimi.
6. Institucioni, të hartojë mekanizma e të përcaktojë indikatorë, për matjen e impaktit konkret dhe të drejtpërdrejtë që ka pjesëmarrja e personelit akademik të këtij programi studimi, në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare.
7. Institucioni, të përmirësojë procesin e funksionimit të qendrës *Life Long Learnig* duke filluar që nga evidentimi i nevojave për trajnim e duke vijuar më tej me planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e trajnimeve, në mënyrë që ti përgjigjet sa më mirë tregut të punës dhe kërkesave të tij.
8. Institucioni, të shohë mundësinë e ngritjes së atelieve, për zhvillimin e terapeve me fëmijët me nevoja të veçanta.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

